



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA VUSHTRRI – OPSTINA VUCITRN



Drejtoria Komunale për Prokurim Publik
14 Nr. 905/23
Dt. 29.08.2023

Duke vendosur në çështjen administrative, sipas Kërkesës për Rishqyrtim të Op. Ek. NPT “ Bajra “ me seli në Prishtinë, kundër Njoftimit mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues të dt. 12.07.2023, pas mbajtjes së seancës jo publike të shqyrtimit të Kërkesës për Rishqyrtim të Op. Ek. në fjalë, në bazë të nenit 108/A pika 10 paragrafi 10.2 të Ligjit për Prokurimin Publik në Kosovë nr. 04/L-042 i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092 dhe nenin 8 pika 8.1.2 paragrafi i të Rregullave për paraqitje të Kërkesës për rishqyrtim pranë Autoritetit Kontraktues, më datën 29.08.2023 bie këtë:

V E N D I M

- 1. Aprovohet si pjesërisht e bazuar Kërkesa për rishqyrtim, e subjektit në procedurë : NPT “ Bajra “ me seli në Prishtinë, e datës 23.08.2023, për rishikimin - rivlerësimin e aktivitetit të prokurimit, respektivisht Njoftimit mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues të datës 18.08.2023 lidhur me aktivitetin e prokurimit : “ Furnizimi me veshmbathje sipas Lot. 1 deri Lot. 5 “, me Nr. Prok: VU644 – 23 – 4017 – 1-2-1 / Nr. i Brendshëm: VU644 – 23 – 039 – 121**
- 2. Anullohet Njoftimi mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues i dt. 18.08.2023**
- 3. Autoritetit Kontraktues – Drejtoria Komunale për Prokurim Publik, në pajtim me dispozitat e nenit 108/1 paragrafi 10.2 të LPP-së do të vazhdoi me ri vlerësim të aktivitetit të prokurimit.**
- 4. Vendimi hynë në fuqi ditën e marrjes.**

A r s y e t i m

Me vendimin e sajë, Autoritetit Kontraktues – Drejtoria Komunale për Prokurim Publik ka marrë vendim që , në aktivitetin e prokurimit : **Furnizimi me veshmbathje sipas Lot. 1 deri Lot. 5 “, Lot. 2 “ Furnizimi me veshmbathje (uniformë) për Njësinë e Zjarrfikësve “ me Nr. Prok: VU644 – 23 – 4017 – 1-2-1 / Nr. i Brendshëm: VU644 – 23 – 039 – 121 , të shpërblej me kontratë Operatorin Ekonomik : “ Sankos “sh.p.k. me seli në Kaçanik.**

Në Kërkesën për rishqyrtim parashtruar nga Op. Ek. NPT “ Bajra “ (në tekstin e mëtejme Ankuesi), Ankuesi konsideron se me këtë vendim janë shkelur dispozitat e LPP-së, 7- Barazia në Trajtim/ Jo diskriminimi, neni – 28 – Specifikimet Teknike, neni 56 – Dispozitat e përgjithshme mbi përzgjedhjen e pjesëmarrësve dhe dhënien e kontratës, neni 59 – Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve.

Pasi u shqyrtuan pretendimet ankimore të Ankuesit të paraqitura në Kërkesën për Rishqyrtim dhe vlerësimit të provave në shkresat e lëndës, u konstatua se Kërkesa për Rishqyrtim e Ankuesit është pjesërisht e bazuar.

Pretendimi ankimor se O.E. i shpërblyer me kontratë nuk ka dorëzuar Deklaratën mbi përmbushjen e Specifikave Teknike të saktësuar në Dosjen e Tenderit nuk qëndron pasi u vërtetua se një Deklaratë e tillë, e nënshkruar dhe vulosur, është dorëzuar bashkangjitur me Dosje e Tenderit.

Po ashtu pretendimi i Ankuesit se Deklarata nën Betim e dorëzuar nga O.E. i shpërblyer me kontratë është dorëzuar gjysmë e plotësuar, sikurse vlerëson A.K., pretendimi nuk qëndron për faktin se të dhënat e O.E. janë evidentuar në Formularin e Deklaratës, e njëjta është nënshkruar dhe vulosur dhe për A.K. ka qenë fare e qartë si qëllimi ashtu dhe përmbajtja e Deklaratës si dhe për cilin aktivitet të

prokurimit është dorëzuar, ndërsa lidhur me mosplotësimin e emrit të O.E. të cilin e përfaqëson, të cilës i referohet Ankuesi, sikurse vlerëson A.K. kjo nuk paraqet devijim substancial nga Kërkesat e saktësuara në Dosjen e Tenderit, prandaj një dokument si i tillë është pranuar si i rregullt, ndërsa pretendimi i Ankuesit është refuzuar si i pabazuar.

Lidhur me pretendimin ankimor të Ankuesit, se A.K. në mënyrë të gabuar ka vendosur të kërkoj informatë sqaruese nga O.E. i shpërblyer me kontratë, sikurse vlerëson A.K. , një pretendim i tillë është i gabuar për arsye se kërkesa për sqarim është bërë lidhur me Specifikimet Teknike të Detyrueshme, Përshkrimin e Pozicioneve të artikujve nën numrin rendorë : 1, 2, 3 dhe 4 të Paramasë/Parallogarisë dhe duke pasur parasysh se kjo ka qenë një kërkesë e Komisionit të Vlerësimit të Tenderëve , kërkesa për O.E. është bërë konform dispozitave të nenit 38 të Rregullores nr. 001/2022, andaj edhe ky pretendim është refuzuar si i pabazuar.

Ndërsa, sa i përket pretendimit ankimor lidhur me Specifikat Teknike të artikullit nën nr. rendor 4 " Patika sportive " respektivisht dizajnit, materialit, formës dhe përshtatshmërisë së artikullit në fjalë, A.K., pasi analizoi edhe njëherë mostrat e dorëzuara nga Njësia Kërkuese e A.K. dhe mostrat e dorëzuara nga tenderuesit në proces, konstatoi padiskutueshëm se mostrat e dorëzuara nga O.E. i shpërblyer me kontratë nuk i përgjigjen as për së afërmi modelit, formatit, dizajnit dhe përshtatshmërisë së mostrave të Njesisë Kërkuese të A.K.. Mbi këtë bazë A.K. ka vendosur që pretendimin ankimor të Ankuesit ta aprovoj si të bazuar.

Lidhur me pretendimin ankimor të afatit të liferimit të mallit, A.K. konstaton se afati i liferimit është saktësuar në Dosjen e Tenderit, pjesa FTD, neni 5.3 dhe i njëjti nuk përbën kriter vlerësimi por kusht të kontratës. Këtë kusht e kanë pranuar të gjithë tenderuesit në proces, pra edhe O.E. i shpërblyer me kontratë, andaj dhe pretendimi ankimor i Ankuesit lidhur me këtë çështje është i pabazuar dhe si i tillë është refuzuar.

Bazuar në të gjitha të cekurat si më lartë në këtë Vendim, A.K. vlerëson se pretendimet e Ankuesit janë pjesërisht të bazuara, me theks të veçantë sa i përket përshtatshmërisë së artikullit nr. 4 si në Paramasë/ Paraloagri, ndërsa që në procedurë të mëtejme A.K. do të luaj rrolin aktiv në përmbushjen e kërkesave të tija duke u kujdesur dhe në zbatimin e drejtë të dispozitave ligjore të LPP-së, posaçërisht nenin 1 - Qëllimi, nenin 6 - Ekonomiciteti dhe efikasiteti, neni 7 - Barazia në trajtim/ Jo diskriminimi si dhe neni 59 - Ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve, andaj edhe pretendimet e Ankuesit lidhur me këto çështje, sikurse ka konstatuar dhe sqaruar A.K. përmes këtij Vendimi, janë aprovuar si pjesërisht të bazuara.

Këshillë juridike:


Pala e pakënaqur me këtë Vendim ka të drjtë të parashtroi Ankesë pranë Organit Shqyrtues për Prokurim – OSHP-së, në pajtim me nenin 109 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092.

Autoriteti Kontraktues – Komuna e Vushtrrisë
K.R.. nr. 039/2023, datë 29.08.2023

Aktvendimi i dërgohet:

1. Palës/ ve
2. DKP
3. Arkivit (1 kopje)

Drejtori i Drejtorisë për Prokurim Publik


Alban Tahiraj